



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/22

Datë: 03.04.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 3 prill 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për përgjimin e telekomunikimeve.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/22
Datë: 03.04.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 3 prill 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Banim Social.
2. Obligohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe institucionet tjera për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/22
Datë: 03.04.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 3 prill 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për mbrojtjen e ajrit nga ndotja.
2. Obligohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe institucionet tjera për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/22

Datë: 03.04.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 14 të Ligjit Nr. 03/L-068 për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 30/15 qershor 2008), duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 3 prill 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti: Procedurat e aplikimit për vende pune në institucionet publike të Republikës së Kosovës, për pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë, që posedojnë diploma të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës Veriut.
2. Autorizohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që të emërojë Ekipin përgjegjës për përgatitjen e Projekt-aktit normativ i cili do të përcaktojë procedurat dhe kriteret për vlefshmërinë e diplomave të lëshuara nga "Universiteti i Mitrovicës së Veriut" të qytetarëve të Republikës së Kosovës për qëllim të aplikimit për vende pune në institucionet publike të Republikës së Kosovës.
3. Ekipi do të paraqesë për shqyrtim dhe aprovim nga Qeveria Projekt-aktin normativ jo më vonë se gjashtë muaj pas themelimit.
4. Obligohen të gjitha ministrinë që të bashkëpunojnë me Ekipin për përmbushjen e mandatit të tij.
5. Sekretarët e Përgjithshëm të ministrive janë përgjegjës për bashkëpunim në mes të ministrive dhe Ekipit.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/22

Datë: 03.04.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 59 të Ligjit Nr. 03/L-163 për Minera dhe Minerale me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 04/L-158, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 3 prill 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës këta kandidatë:
 - 1.1. z. Musa SHABANI
 - 1.2. z. Festim KUTLLOVCI
 - 1.3. z. Selim FRANGU
 - 1.4. z. Avdi KONJUHI
 - 1.5. z. Kemajl ZEQRIRI
 - 1.6. z. Shpend TERDEVA
 - 1.7. z. Bekim TRONI
 - 1.8. z. Azem REXHAJ.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit, që Vendimin së bashku me biografite e kandidatëve të propozuar t'ia procedoj për shqyrtim dhe emërim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/22

Datë: 03.04.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 3 prill 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Inicohet përgatitja e Programit Kombëtar të Republikës së Kosovës për Adoptimin e Acquis-së së BE-së (PKAA), në përputhje me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA) në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian.
2. Vendimi përcakton strukturën dhe përmbajtjen e Programit, siç është paraparë në Shtojcën nr. 1 të këtij vendimi, dhe përgjegjësitë e institucioneve, siç është paraparë në Shtojcën nr. 2 të këtij vendimi. Sipas nevojës, institucionet kryesore përgjegjëse për kapitujt e veçantë mund të ftojnë institucione të tjera që marrin pjesë në punën e grupeve me të cilat udhëheqin.
3. Obligohet Ministria e Integritimit Evropian të bëjë koordinimin e procesit të përgatitjes së PKAA-së, si dhe të përgatisë udhëzimet për përpilimin e këtij dokumenti për të gjitha palët e përfshira në këtë proces. Këto udhëzime gjithashtu do të përcaktojnë afatet kohore për hartimin dhe ato të zbatimit të PKAA-së.
4. Obligohen organet e Administratës Shtetërore që t'u përmbahen detyrave, në përputhje me Shtojcën 2 të këtij vendimi, dhe afateve kohore të përcaktuara në bashkëpunim me MIE-në, ashtu siç do të parashihet me udhëzimet e parapara në pikën 3 të këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/22

Datë: 03.04.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 3 prill 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Platforma Vjetore e Agjencisë Kosovare të Inteligjencës.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Platformën nga pika 1. e këtij vendimi t'ia dërgoj për informim Komisionit për Agjencinë Kosovare të Inteligjencës në Kuvendin e Kosovës, dhe Drejtorit të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë për veprim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/22

Datë: 03.04.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 3 prill 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

- Themelohet Komisioni Qeveritar për Manifestimin gjithë-popullor "Ditët e Shqipës" përvjetori i Betejës së Koshares e cila do të organizohet nën patronatin e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Isa Mustafa, në këtë përbërje:
 - Ministër i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Kryesues;
 - Zëvendëskryeministri dhe Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, anëtar;
 - Një Këshilltar i Kryeministrit, anëtar;
 - Shefi i Protokollit në Ministrinë e Punëve të Jashtme, anëtar;
 - Zëvendësministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, anëtar dhe
 - Një përfaqësues i Komunës së Junikut, anëtar.
- Ndahen mjete financiare në shumën prej 10,000.00 (dhjetë mijë) euro të cilat do të shfrytëzohen sipas nevojës për manifestim.
- Mjetet financiare nga pika 2. e këtij vendimi ndahen nga Rezervat e Qeverisë, dhe barten në kodin nr. 10700 në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime, në Zyrën e Kryeministrit.
- Obligohet Komisioni, Ministria e Financave dhe Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/22

Datë: 03.04.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 3 prill 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/62 i datës 22 shkurt 2012 për Themelimin e Komisionit Ndërmintor për udhëheqjen e projektit për zhvillimin e Brezovicës dhe për zbatimin e procedurave me qëllim të zhvillimit të projektit duke u bazuar në investimet private si në vijim: nënpikat nga 1.1. deri 1.7. zëvendësohen me tekstin si vijon:
 - 1.1. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Kryesuese;
 - 1.2. Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, anëtar;
 - 1.3. Ministri i Financave, anëtar;
 - 1.4. Ministri i Integritit Evropian, anëtar;
 - 1.5. Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, anëtar;
 - 1.6. Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, anëtar dhe
 - 1.7. Kryetari i Komunës së Shtërpçës, anëtar.
2. Pjesa tjetër e Vendimit Nr. 09/62 të datës 22 shkurt 2012 mbetet e pandryshuar.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/22

Datë: 03.04.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet nr. 03/L-221, nr. 04/L-165 dhe nr.04/L-194, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 3 prill 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 27,500 (njëzeteshtatë mijë e pesëqind) euro nga nën-programi - Shpenzimet e paparashikuara me kod 131 për Komunën e Vitisë për dëmet e shkaktuara nga vërshimet.
2. Obligohet Komuna e Vitisë të njoftoj Ministrinë e Financave për programin dhe kategorinë ekonomike ku do të ndahen këto mjete.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Komuna e Vitisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë